



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, më datë **07.06.2024** ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: “Kërkesë për pushimin e procedimit penal nr. 75 të vitit 2021”, me kallëzues shtetasin A.Sh.

2. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtari Erjon Çela, bazuar në nenet 112, 190, 328/1 germa “b” dhe 329/b pika 3 të K.Pr.Penale, me vendimin **Nr. 87, datë 22.07.2024**, vendosi:

1. Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.
2. Pushimin e çështjes penale që i përket procedimit penal **Nr. 75 të vitit 2021** i Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, regjistruar për veprën penale “*Ushtrim i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike*” parashikuar nga neni 245/1 i K.Penal dhe “*Falsifikim i dokumentave*” parashikuar nga neni 186 i K.Penal, pasi në zbatim të nenit 328/1 pika 1, germa “b”, të K.Pr.Penale, fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, brenda 15 ditëve, afat i cili fillon nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit të gjykatës.

Tiranë, më datë 22.07.2024

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar